

# 4PROTECTION

## MBROJTËS DEKORATIV PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME

Seri 321

### PËRSHKRIMI

4PROTECTION është ideal për mbrojtjen e sipërfaqeve të brendshme, absorbuese, të llojeve të ndryshme që mund të dëmtohen gjatë përdorimit të përditshëm. Krijon një barrierë shumë të hollë të kthyeshme, jo filmogjene, mbrojtëse, rezistente ndaj pastrimit të zakonshëm dhe larjeve, të cilat nuk ndikojnë në efektin estetik dhe rezultojnë të këndshme për syrin dhe prekjen.

Duke shfrytëzuar sinergjinë (bashkëpunimin) e komponentëve të fluorkarbonit dhe parafinës, I jep sipërfaqes rezistencë të mirë ndaj substancave të hollueshme me ujë dhe vaj.

Nuk lejon depozitim të papastërtive të yndyrnave dhe kufizon formimin e mykut dhe algave.

Mund të aplikohet në sipërfaqe të ndryshme me kusht që të jenë kohezive, absorbuese dhe të thata.

Përsa I përket aplikimit të tij, është i përshtatshëm për mbrojtjen dhe dekorimin e sipërfaqeve vertikale të banjove dhe kuzhinave.

Formulimi në krem lejon një përdorim të lehtë dhe efikas.

### UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

Mund të aplikohet në:

- Finitura dekorative me natyrë minerale
- Finitura dekorative me natyrë organike
- Bojra me bazë uji
- Materiale guri, gur gëlqeror, mermer, gur natyral ose i rindërtuar (përpunuar)
- Tulla të ekspozuara (në sipërfaqe të brendshme)
- Sipërfaqe betoni

Aplikimi në sipërfaqe pjesërisht opake, I ndryshon aspektin estetik.

Për pastrimin e sipërfaqes përdorni rrobë/leckë të thatë.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Natyra e lidhësit: dispersion ujor i çerave/dyllit me modifikim fluorkarbonik.

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1:  $1.01 \pm 0,05$  g / ml

-Viskoziteti: pastë kremoze.

-Koha e tharjes: (ne 25 ° C dhe 65% RH): prekja pas 30 minutash, tharja totale pas 4 orësh.

-Performanca optimale e rezistencës së vaj-ujë arrihet normalisht 5 ditë pas aplikimit.

### PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Për të gjitha sipërfaqet:

Para se të aplikoni 4PROTECTION sipërfaqet duhet të jenë kompakte, tërësisht të thata.

Përpara se të vazhdoni me aplikimin e mbrojtësit 4PROTECTION, prisni të paktën 24 orë nga aplikimi në finiturë organike me trashësi të ulët dhe të paktën 48 orë në marmorino ose të ngjashëm me natyrë minerale.

### UDHËZIMET E APLIKIMIT

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:

Temperatura e ambientit : Min +5°C/+35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75 %

Temperatura e sipërfaqes: Min +5 °C/+35 ° C.

Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Mjetet: furçë, rrobë leshi.

-Hollimi: gati për përdorim.

-Nr.i shtresave: 1-2 shtresa në varësi të nivelit të ngopjes së kërkuar.

-Produkti thahet brenda 4 orëve, sipërfaqet e trajtuara duhet të mbrohen nga shiu për të paktën 12 orë.

-Numri I shtresave: të paktën 1. Shtresa pasardhëse duhet të aplikohet pasi të kenë kaluar 4 orë nga aplikimi I shtresës së parë.

-Metoda e aplikimit:

# 4PROTECTION

## MBROJTËS DEKORATIV PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME

### Seri 321

Aplikoni një shtresë të hollë të 4PROTECTION duke përdorur një furçë ose rrobë leshi.

Kur sipërfaqja e dekoruar, aplikuar me 4PROTECTION është tharë për prekje (rreth 30 minuta pas aplikimit), luçidojeni me një rrobë.

Sipërfaqet mund të luçidohen manualisht ose me një rrashinues black&decker me xhiro normale, me kapak leshi.

-Shkalla e mbulimit: ndikohet shumë nga lloji i finiturës ose materialit që do të mbulohet. Në sipërfaqet lisho mesatarisht absorbuese, mbulon maksimalisht 15 m<sup>2</sup>/l për shtresë.

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e sipërfaqeve të trajtuara me 4PROTECTION përdorni një rrobë leshi ose me mikrofibër të thatë ose të lagur me ujë në varësi të llojit të pastrimit.

Sipërfaqet kanë rezistencë të mirë ndaj një varieteti të gjerë substancash me përdorim shtëpiak.

Sugjerohet që mbetjet e substancave agresive të pastrohen shpejt dhe të lahen me ujë, në mënyrë që të shmangen kontaktet e zgjata.

Për të hequr papastërtitë që mbeten mund të përdorni ujë dhe detergjentë dyshemeje. Mos përdorni agjentë alkaline ose acid të fortë, pasi mund të dëmtojë sipërfaqen e trajtuar me 4PROTECTION.

### NGJYRIMI

Produkti është i disponueshëm pa ngjyrë, transparent (0001).

### MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e magazinimit: +30°C

Temperatura minimale e magazinimit: +5°C  
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte temperature të përshtatshme.

### TË DHËNA MBI SIGURINË

Nuk përfshihet në direktivat e BE 2004/42 (dekrete legjislativ 161/2006).

Produkti nuk kërkon etiketim sipas normave aktuale. Përdoreni produktin sipas normave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; pas përdorimit, mos hidhni ambalazhet në ambient, lërini mbetjet të thahen dhe i trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mbajini larg përdorimit nga fëmijët. Në rast të gëlltitjes konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni ambalazhin ose etiketën.

Mos i hidhni mbetjet në kanalizime, korsi ujore apo në terren.

Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

### EMËRTIMI

Mbrojtës i kthyeshëm, jo filmogjen me bazë dispersion ujor të çerave/dyllit me modifikime fluorkarbonike 4PROTECTION seri 321.

Duke shfrytëzuar sinergjinë (bashkëpunimin) e komponentëve, i jep sipërfaqes rezistencë të mirë ndaj substancave të hollueshme me ujë dhe vaj. Nuk lejon depozitimin e papastërtive të yndyrnave dhe kufizon formimin e mykut dhe algave.

Shkalla e mbulimit: mbulohen deri në 15 m<sup>2</sup> /l për shtresë, në varësi të absorbimit të finiturës.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € ..... për m<sup>2</sup>.

# 4PROTECTION

MBROJTËS DEKORATIV PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME

Seri 321

*SAN MARCO GROUP* garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.

Eraldi Shpk